



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/02-0013410/19
Kaçanik, 28.06.2019

Në bazë të nenit 12.2, 14.1 lidhur me nenin 17 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 6 pika 1.2 lidhur me nenin 19 pika 3.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 –Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03 Prill 2019), të nenin 6.2(h) të Statutit të Komunës, duke vepruar sipas Rekomandimit të Komisionit vlerësues prej datës 15.05.2019- dërguar me Shkresë përcjellëse me Numër të Protokollit, 01Nr. 060/01-14677/19 të datës 16.05.2019, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur më 28 Qershor 2019, mori këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN NË SHFYTËZIM AFATGJATË (40 vjet) PARCELËN KADASTRALE NR. P-70917021-00217-3 ZONA KADASTRALE GËRLICË E EPËRME DHE PARCELA KADASTRALE NR. P-70917026-00124-1 ZONA KADASTRALE DOGANAJ, N.T.P. "MUJA" NGA F. DURAJ

1. Me këtë vendim, I jepet në shfrytëzim afatgjatë – **për 40 (katërdhjetë) vjet**, Kompanisë shërbyese dhe veprimtari të tjera **N.T.P. "Muja" me pronarin, Muhamet Zenuni nga f. Duraj** i Komunës Kaçanik, me numër të rexhistrimit të biznesit, 80124163 me aktivitet të biznesit, shërbime dhe veprimtari të tjera, këto Parcela Kadastrale:
 - 1.1. Parcela Kadastrale me Nr. P-70917021-**00217-3**, P.SH.K.K. Kaçanik, në vendin e quajtur "Kërdhak –Toska" Zona Kadastrale Gërlica e Epërme- Kaçanik në sipërfaqen e aprovuar **1356m²** si dhe
 - 1.2. Parcela Kadastrale me Nr.P- 70917026-**00124-1**, PSH. K.K. Kaçanik, me kulturë kullosë e klasës së 5 (pestë) në vendin "Kaliman Vore të Tenes" Zona Kadastrale Doganaj-Kaçanik, në sipërfaqe e aprovuar, **4218m²**.
2. Parcelat Kadastrale të potencuar në këtë vendim, jepen në shfrytëzim afatgjatë për 40(katërdhjetë) vjet, me destinim për: zgjerimin e biznesit-hapja e një kompleksi universal për shumë shërbime, shtimin numrit të vendeve të punës, 20-50 punëtorë, vlera e investimit, 2.000.000€(dy milion euro) si dhe mbrojtjen e ambientit.
3. E drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme, nuk mund të bartet në shfrytëzim të personave të tretë.
4. Obligohet Kryetari i Komunës që të nënshkruajë Kontratë me kompaninë fituese si në pikën 1. të këtij vendimi- me kompaninë: N.T.P "Muja" në të cilën kontratë do të përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese, konform nenit 19, paragrafit 3.2 të Ligjit Nr. 06/L-092 – Për Dhënie në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

5. Për Mbikëqyrjen dhe realizimin e kontratës do të kujdeset, Kryetari i Komunës, i cili konform dispozitave të nenit 22 të Ligjit Nr. 06/L-092 – Për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, obligohet të paraqet raport 6 mujor Kuvendit të Komunës dhe raport të veçantë për realizimin dhe përmbushjen e qëllimit të dhënies së pronave komunale në shfrytëzim si dhe veprimet tjera(masat e caktuara ndaj shfrytëzuesit- përshtirë edhe rekomandimin për shkëputje të kontratës) që duhet të merren në rast të mosrealizimit të planit dinamik dhe kushteve të përcaktuara në kontratë.
6. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës. Kryetari i Komunës është i obliguar të njoftoj Kuvendin e Komunës, duke përshkruar gjendjen aktuale të pronës si dhe të jap propozime për destinimin e pronës në të ardhmen, konform pikës 2 të nenit 23 të Ligjit me numër të theksuar si më lartë.
7. Konform pikës 3 të nenit 23 të ligjit të theksuar si në pikën 4 të këtij vendimi, pas përfundimit të kontratës për shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, mund të vazhdohet afati i dhënies në shfrytëzim në bazë të përformancës.
8. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit Ekonomik.
9. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL , si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës -(përmes Zyrës së Kryetarit njoftohet, pala), Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e Administrimit të Pushtetit Lokal Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme
Nga:	Xhevat Tafa, U.D i Udhëheqësit të Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL Datë: 08/07/2019 Nr.020-783
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 01Nr.104/02-0013410/19 për dhënien në shfytëzim afatgjatë (40 vjetë) Parcelën Kadastrale Nr. P-70917021-00217-3 Zona Kadastrale Zona Kadastral Gërlicë e Epërme dhe Parcela Kadastrale Nr.P-70917026-00124-1Zona kadastrale Doganaj NTP 'Muja' nga F. Duraj.

I miratuar më datë: 28.06.2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.07.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MIEDIST DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA/IZVOD IZ CERTIFIKATA/EXTRACT OF CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : P.SH. KUVENDI I KOMUNËS KAÇANIK

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:
Komuna / Opština / Municipality:
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

941-19313/2019
28.06.2019 - 09:39
Kaçanik / Kačanik / Kačanik
Kaçanik / Kačanik / Kačanik

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i atarizimit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Licni broj/broj poslovanja ID. No.	Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Drzava državljanstva ili ukupljenja Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishmen t	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P.SH. KUVENDI I KOMUNËS KAÇANIK			/	KCID0900146	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO			24.02.2016

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhuruar Azurirano Updated
KAÇANIK / KAČANIK / KAČANIK		EMIN DURAKU 2	KAÇANIK	24.02.2016

B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

Njësia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale Katastarska zona Cadastral zone	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type / Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind	Kat/ Katet Br. Sprat a/ Spratova Floor number	Vendi i kualitur Zvano mesto Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shfrytëzimi aktual/Kultura- klasa Aktualna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azhuruar Azurirano Updated
P-70917021-00217-1	Kaçanik / Kačanik / Kačanik	GËRLICË E EPËRME / GORNJA GRLICA / GURASI	PARCELË / PARCELA / parcel parcel	Pronë shoqëtorë Društvena Imovina Socially owned Land / R		KËRDHAK-TOSKA / KËRDHAK-TOSKA / KËRDHAK-TOSKA	6609	Shërbimet Publike - Varrëzë - / / Javne Usluge - Grobje - / / PublicServices - cemetery - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drazavina / single possessor	28.06.2019
P-70917021-00217-2	Kaçanik / Kačanik / Kačanik	GËRLICË E EPËRME / GORNJA GRLICA / GURASI	PARCELË / PARCELA / parcel parcel	Pronë shoqëtorë Društvena Imovina Socially owned Land / R		KËRDHAK-TOSKA / KËRDHAK-TOSKA / KËRDHAK-TOSKA	1355	Infrastruktura - Rrugë E Pakatëgor - / / Infrastruktura - Nekategorisani Put - / / Infrastructure - UncategorizedRoa d - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drazavina / single possessor	28.06.2019
P-70917021-00217-3	Kaçanik / Kačanik / Kačanik	GËRLICË E EPËRME / GORNJA GRLICA / GURASI	PARCELË / PARCELA / parcel parcel	Pronë shoqëtorë Društvena Imovina Socially owned Land / R		KËRDHAK-TOSKA / KËRDHAK-TOSKA / KËRDHAK-TOSKA	1356	Shërbimet Publike - Varrëzë - / / Javne Usluge - Grobje - / / PublicServices - cemetery - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drazavina / single possessor	28.06.2019



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY


KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Gërlicë e epërme

341/01-14313/2019

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-70917021-00217-1		
P-70917021-00217-2		
P-70917021-00217-3		



Shkalla/Razmera/Scale: 1:973

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 28.06.2019

Koha/ Vreme/ Time: 08:10:12

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MIEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA/IZVOD IZ CERTIFIKATA/EXTRACT OF CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : P.SH. KUVENDI I KOMUNËS KAÇANIK

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	941-19313/2019
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	28.06.2019 - 09:36
Komuna / Opština / Municipality:	Kaçanik / Kačanik / Kačanik
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	Kaçanik / Kačanik / Kačanik

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i afatizantit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Licenç broj/broj ID. No.	Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Drzava državljanstva ili uknjiženja Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishmen t	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P.SH. KUVENDI I KOMUNËS KAÇANIK			/	KCID0900146	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO			24.02.2016

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhuruar Ažurirano Updated
KAÇANIK / KAČANIK / KAČANIK		EMIN DURAKU 2	KAÇANIK	24.02.2016

B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

Njësia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale Katastarska zona Cadastral zone	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type / Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind	Kati/ Katet Br./Sprat a/ Floor number	Vendi i quajtur Zvano mesto Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shprehjetimi aktuale/Kultura- klasa Aktualna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azhurnuar Ažurirano Updated
P-70917026-00124-1	Kaçanik / Kačanik / Kačanik	DOGANAJ / DOGANOVIC / DOGANAJ	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / R		KALIMAN VORE TE TENES / KALIMAN VORE TE TENES / KALIMAN VORE TE TENES	4218	Bujqësore - Kulllosat - Kulllosë E Klasës 5 / / Poljoprivredno - Pasnjaci - Pasnjak 5 Klase / / Agriculture - pasture - 5th Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor	28.06.2019
P-70917026-00124-2	Kaçanik / Kačanik / Kačanik	DOGANAJ / DOGANOVIC / DOGANAJ	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / R		KALIMAN VORE TE TENES / KALIMAN VORE TE TENES / KALIMAN VORE TE TENES	327	Infrastruktura - Rrugë E Pakategor - / / Infrastruktura - Nekategorisani Put - / / Infrastructure - UncategorizedRoa d - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor	28.06.2019



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY


KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Doganaj

941/01-13313/2019

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-70917026-00124-2		
P-70917026-00124-1		



Shkalla/Razmera/Scale: 1:782

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 28.06.2019

Koha/ Vreme/ Time: 08:05:05

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT • OPŠTINA KAÇANIK • MUNICIPALITY OF KAÇANIK

<http://kk.rks-gov.net/kacanik/>

16.05.2019
KACANIK
01 604-86677
KAÇANIKU



KOMISIONI PËR DHËNIEN E TOKAVE NË SHFRYTËZIM

DATA/DATUM/DATE	15.5.2019
01 NR/BR.	Zyrtarisht
PËR/ZA/TO	z.Kemal Murseli - Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM	Kryesues i Komisionit
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Raporti i Komisionit Vlerësues



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E KAÇANIKUT • OPŠTINA KAÇANIK • MUNICIPALITY OF KAÇANIK

<http://kk.rks-gov.net/kacanik/>



KOMISIONI PËR DHËNIEN E TOKAVE NË SHFRYTËZIM

DATA/DATUM/DATE	15.5.2019
01 NR/BR.	Zyrtarisht

PËR/ZA/TO	Kryesuesit të Kuvendit të Komunës z.Kemal Murseli
NGA/OD/FROM	Komisioni Vlerësues: Kadri Krivenjeva Kaltrina Tafili Besnik Salihu Zekirja Elezi Besnik Bajra Hidajete Guri Remzi Shabani
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Rekomandim i Komisionit për përzgjedhjen e ofertës ekonomikisht më të favorshme

I nderuar,

Duke u bazuar në nenet 2,3 parag.1.4, nenet 6, 7, 8 të Ligjin Nr.04/L-144, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 18 në Rregulloren QRK Nr.23/2013 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, Komisioni Vlerësues i ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim, në sallën e komiteteve të Kuvendit Komunal, me dt. 07.05.2019 pas përfundimit të konkursit publik, ka bërë **përzgjedhjen e ofertës ekonomikisht më të favorshme, për aprovim në Kuvendin e Komunës :**

Më poshtë keni të dhënat në formë tabelare:

Të dhënat kryesore	
Kompania	N.T.P.'Muja"
Numri i Parcelës	70917026-124-0
Përshkrimi i pronës	Pronë shoqërore
Vendi i Pronës	Doganaj -Kaçanik
Sipërfaqja e aprovuar	5574 m ²
Kohëzgjatja e aprovuar	40 vite

Më poshtë keni të dhënat në formë tabelare:

Të dhënat kryesore	
Kompania	N.T.P.'Muja"
Numri i Parcelës	70917021-217-0
Përshkrimi i pronës	Pronë shoqërore
Vendi i Pronës	Gërlicë e Epërme -Kaçanik
Sipërfaqja e aprovuar	1356 m²
Kohëzgjatja e aprovuar	40 vite

Vërejtje: N.T.P."Muja" i jepen në shfrytëzim nga komuna, parcela kadastrale 124-0, me sipërfaqe prej 4218 m² dhe një pjesë nga parcela 217-0, zona kadastrale Gërlicë e Epërme në sipërfaqe prej 1356 m² në total kompanisë së lartshenuar i ipen në shfrytëzim **5574m²**.



Formulari per kerkese apo ankese

Drejtorati/Njesia

Shërbimi i Kryetarit

Data 03/05/2019

1. Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:

Emri dhe mbiemri

N.P.T "Muja"

Numri personal

/

Adresa e vendbanimit

Kaçanik

E-mail Adresa

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

2. Mënyra e pranimit

Kërkesa

Statusi i lëndës

Ne proces

Vlera për pagesë: 0.00

Mos shkruani në këtë pjesë

Numri i protokolit

01-104/02-0013410/19

Afati i zgjedhjes

02/06/2019

Vendimi

3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

Aplikacin për marrjen në shfrytëzim afatgjat të pronës komunale

4. Dokumentet e bashkangjitura:

Nr. Lloji i dokumentit

5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë N.P.T "Muja" vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.


(Nënshkrimi)

*Ju lutemi të kërkonit nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura

Pranuar nga: Hetem.Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT • OPŠTINA KAÇANIK • MUNICIPALITY OF KAÇANIK



**KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN E PRONËS
SË PALUJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM**

**APLIKACIONI PËR MARRJEN NË SHFRYTËZIM
AFATGJATË TË PRONËS KOMUNALE**

Formular për Aplikim

Kaçanik, 2019

Parcela kadastrale për të cilën konkuroni të merrni në shfrytëzim të parapara me Konkursin Publik.

Parcela kadastrale nr.

00121-0, 124-0

00217-0

I. Të dhënat themelore të aplikuesit.

Emri i aplikuesit për personin fizik
Ose personin juridik- emri i biznesit

Muhamet Zenuni - NPT MUJA

Adresa

Durrës

Komuna

Raqyanik

Shteti

Kosovë

Tel/fax

044 130 299

Numri Personal

1011940940

E mail adresa:

info@muja-ns.com

I.a). Statusi juridik.

I.b) Nr.i regjistrimit të biznesit

80124163

I.e) Nr. Fiskal

600682688

I.c) Aktiviteti i biznesit

prodhim ☐

montim ☐

shërbime ☒

veprimtari tjera ☒

I.d) Përshkrimi i shkurtër i biznesit (plani i biznesit).

Prodhim

Montim

Përpunim

Shërbime

Veprimtari tjetër

2. Numri i vendeve të punës:

Egzistuese

44

Propozuara

20-50

3. Vlera e investimeve: në Euro Me fjalë (...Dy milion...).

4. Teknologjia:

Teknologjia e re

☒

Viti i prodhimit

Teknologjia e përdorur

☐

Viti i prodhimit

5. Hapësira e kërkuar për marrjen në shfrytëzim të pronës: m².

Shkurtimishtë arsyetimin për pronën e kërkuar për shfrytëzim

Sqarim nuk është përveçse parcela me Nr 00121-0 me
Superfacc 1300 m²
Qellimi i kësaj pronë është zëritimi i biznesit dhe krijimi
i vendeve të punës si dhe mbrojtja e Ambientit

6. Efektet në ambient:

6.a A e ndotni ambientin me aktivitetin tuaj:

- JO ☒ (arsyetoni me fjalë) Sepse Biznesi jam nuk e ndotë Ambient
➤ PO ☐ (arsyetoni me fjalë)

6.b Nëse PO ju e ndotni:

* Ajrin ☐ Tokën ☐ Ujin ☐ Bëni zhurma ☐

6.c Masat mbrojtëse që i ndërmerreni në rast se ndotni ambientin (bëni shkurtimishtë
specifikimin e atyre masave

.....
.....
.....

7. Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Fletë aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar.
- Letërnjoftimi fotokopje.
- Certifikata e regjistrimit të biznesit (për subjektin juridik).
- Biografia e kompanisë ose e personit fizik që aplikon.
- Referenca për kompaninë ekgzistuese.
- Vërtetim për përmbushjen e obligimeve tatimore ndaj ATK (për bizneset vendore).
- Dëshminë për përmbushjen e obligimeve ndaj Komunës (për bizneset vendore dhe personat fizik).
- Plani i biznesit.
- Projekti ideor.
- Plani dinamik i investimeve.
- Dëshmi nga Gjykata:
 - Për personat juridik - dëshmi nga Gjykata që biznesi nuk ka falimentuar ose insolvent gjatë dy viteve të fundit dhe ndaj të njëjtit nuk është inicuar procedura e likuidimit apo falimentimit .
 - Për personat fizik dëshmi nga Gjykata që nuk është nën hetime.

8. Të dhënat plotësuese që lidhen me biznesin tuaj (si motivimi për biznes,eksperienca) etj.

Plani i aplikimit i Ktyre pranuar për shfrytëzim në tërësi në
Biznesin tërësisht në Divitet e Fundit me këmbë të
në tërësinë e tërësisë së shpërndarë dhe Ky Biznes
përputhet me investimet e Andhake që është në interes
të gjykatave të Kosovës

Data e aplikimit:

Kaçanik 03/05 2019.

Nënshkrimi i aplikuesit:

[Signature]



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Shërbimi i kuvendit-

01Nr. 60/01 - 14010/19
Kaçanik, 06.05.2019

PROCESVERBAL

Nga mbledhja IV (katër) e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, e mbajtur me datë: 06 Maj 2019. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve të kuvendit, me fillim pune prej orës 10:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës ishin:

1. Kadri Krivenjeva nga PDK,
2. Kaltrina Tafili nga LVV,
3. Besnik Salihu nga LDK,
4. Besnik Bajra nga ekzekutivi i komunës dhe
5. Zekirja Elezi, ekspert i kadastrit nga OJQ

Ndërsa anëtarët Hidajete Guri dhe Remzi Shabanjani munguan në takim.

Mbledhjen e kryesoi, Besnik Bajra kryesues i komisionit.

Procesmbajtëse: Arbnora Kuka, asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

Kryesuesi i Komisionit, z. Besnik Bajra, i përshëndes të pranishmit në mbledhje dhe ju falenderoj për pjesëmarrje në takim dhe hap mbledhjen e IV-të të Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të datës 06.05.2019, me këtë:

REND PUNE

1. Hapja e ofertave lidhur me ankandin publik për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave komunale.

Kryesuesi i Komisionit, z. Besnik Bajra, të nderuar anëtarë të Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, jeni të njoftuar lidhur me konkursin publik të publikuar në web faqen e komunës më datë 20.03.2019, i cili konkurs ka zgjatur 45 ditë. Në këtë konkurs publik kanë aplikuar vetëm dy persona juridik.

Z.Zekirja Elezi. Të dy aplikantët kanë aplikuar në një vend , por që janë të ndara në dy zona kadastrale.

Z.Besnik Salihu. A kanë sjellur aplikantët ndonjë plan të biznesit ,se çfarë biznesi planifikojnë të hapin në këto parcele a.

Kryesuesi i Komisionit,z.Besnik Bajra.Janë dy parcela ,mirëpo çështja e rrugës në këto parcela nuk është e definuar dhe mendoj që çështja e rrugës të mbetet e hapur.Ne si Komision të bëjmë një raport për Kryetarin dhe për Kuvendin komunal që çështja e rrugës të mbetet e hapur.

Z.Kadri Krivenjeva. A janë të njoftuar aplikantët për çështjen e rrugës?

Kryesuesi i Komisionit,z.Besnik Bajra. Palët janë të njoftuar me këtë çështje.

Z.Besnik Salihu. Nëse e bëjmë këtë ndarje të rrugës , a kanë të drejtë ankese palët që kanë aplikuar për këto parcela?

Z.Zekira Elezi. Nëse në nenin 5 të Ligjit për dhënien në shfrytësim të pronës së paluajtshme të komunës është e rregulluar çështja e Planit Zhvillimor Komunal,atëherë ne mund të bëjmë këtë ndryshim.

Z.Besnik Salihu. A ka pasur persona të tjerë të interesuar të aplikojnë për këto parcela?

Kryesuesi i Komisionit,z.Besnik Bajra. Nuk ka pasur aplikant të tjerë të interesuar. Fillojmë me hapjen e ofertave.Të dy ofertat janë të protokoluara.

1.N.P."X-PLAST", numri aplikacionit 01-104/02-13023, data e aplikimit 30.04.2019.

2.N.P.T."MUJA", numri i aplikacionit 01-104/02-13410, data e aplikimit 03.05.2019.

Ne si Komision më datë 22.02.2019 kemi bërë kërkesë në Gjykatën Themelore, dega në Kaçanik, rreth këtyre pronave të paluajtshme të komunës që do të jepen në shfrytëzim, nëse kanë ndonjë kontest gjyqësor.Kërkesë të njëjtë i kemi drejtuar dhe Drejtorisë për Urbanizëm,Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Zyrtarit Ligjor të Komunës,z.Illir Lumi.

Konkursi Publik ka qenë i hapur nga data 20.03.2019 dhe afati për aplikim për këto parcela ka qenë 45 ditë, konkret sht deri më datë 04.05.2019. Hapja e ofertave bëhet sot, me datë 06.05.2019. Palët kanë qenë të njoftuar që hapja e ofertave bëhet sot.

1.N.P."X-PLAST", nr i aplikacionit 01-104/02-13023, me pronar Nexhat Vogliqi, data e aplikimit 30.04.2019. Dokumentet të cilat i posedon janë:

- 1.Aplikacionin e plotësuar,
- 2.Çertifikata e biznesit,
- 3.Letërnjoftimin,
- 4.Vërtetimin tatimorë,
- 5.Çertifikata nga Gjykata Themelore në Prishtinë,
- 6.Referenca për kompaninë,
- 7.Vërtetimin nga Komuna që nuk ka obligime ndaj komunës,
- 8.Plani i biznesit dhe
- 9.Projekti ideor.

Qëllimi i kompanisë është hapja e një fabrike prodhuese të tekstilit dhe punësimin e 35 punëtorëve (30 femra dhe 5 meshkuj).

N.P."X-PLAST" ka aplikuar për parcelën kadastrale 217-0. Z.K. Gërlaç e Epërme.

Në bazë të aplikacionit të kërkuar nga Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, kompania i posedon të gjitha dokumentet e nevojshme.

2.N.P.T."MUJA", numri i aplikacionit 01-104/02-13410, me pronar Muhamet Zenuni, data e aplikimit 03.05.2019. Dokumentet të cilat i posedon janë:

- 1.Aplikacionin e plotësuar,
- 2.Certifikata e biznesit,
- 3.Letërnjoftimin,
- 4.Vërtetimin tatimorë,
- 5.Certifikata nga Gjykata Themelore në Prishtinë,
- 6.Vërtetimin nga Komuna që nuk ka obligime ndaj komunës dhe
- 7.Plani i biznesit.

Qëllimi i kompanisë është hapja e një kompleksi universal për shumë shërbime dhe punësimi i 20-50 punëtorëve.

Në bazë të aplikacionit të kërkuar nga Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, kompanisë i murgon plani dinamik dhe referenca për kompaninë, si dhe në vërtetimin e ATK-së, shkruhet se kompania ka obligime ndaj ATK-së.

Z.Zekirja Elezi, Duhet të dihet interesi i komunës për këtë pjesë, a përputhen me këto kërkesa.

Kryesuesi i Komisionit,z.Besnik Bajra, Kon una me Plan Zhvillimor Komunal, këtë pjesë e ka destinuar si zonë industriale, kështu që përputhen kërkesat e ofertuesve me interesat e komunës.

Z.Zekirja Elezi, N.P.T."MUJA", duhet t'i kërkojmë që të sjellë planin dinamik, referenca për kompaninë dhe na duhen informata shtesë se pse ka obligime ndaj ATK-së. Për momentin nuk mund të vendosim.

Komisioni vendosi që mbledhja të shtyhet për nesër, konkretisht më datë 07 Maj 2019, për shqyrtimin e më tutjeshëm të ofertave.

Procesmbajtës
Arbnora Kuka

Kryesues i Komisionit
Besnik Bajra



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Shërbimi i kuvendit-

01Nr. 60/03-14009/19
Kaçanik, 07.05.2019

PROCESVERBAL

Nga mbledhja V (pestë) e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, e mbajtur me datë: 07 Maj 2019. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve të kuvendit, me fillim pune prej orës 11:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës ishin:

1. Kadri Krivenjeva nga PDK,
 2. Kaltrina Tafili nga LVV,
 3. Besnik Salihu - LDK
 4. Zekirja Elezi, ekspert i kadastrit nga OIQ
 5. Besnik Bajra nga Ekzekutivi i komunës
 6. Hidajete Guri - nga Ekzekutivi i Komunës
- Ndërsa, Remzi Shabani nga Ekzekutivi i komunës, ka munguar në takim.
- Në takim morën pjesë edhe përfaqësuesit e kompanive që kanë aplikuar në ankand publik, Asim Vogliqi- N.P. "X-PI AST" dhe Muhamet Zenuni- N.P.T. "MUJA".

Mbledhjen e kryesoi, Besnik Bajra kryesues i komisionit.
Procesmbajtëse: Arbnora Kuka, asistente e kryesuesit të kuvendit.

Kryesuesi i komisionit, z. Besnik Bajra. Në takimin që kemi pasur dje, më datë 06 Maj 2019, i kemi shqyrtuar ofertat e dy kompanive, mirëpo nuk kemi arritur të marrim një vendim, për shkak të disa sqarimeve të nevojshme nga N.P.T. "MUJA", rreth marrëveshjes me ATK-në.

Z. Muhamet Zenuni. Këtë obligim që kam ndaj ATK-së, ka të bëjë me një denim dhe pagesë të këtij denimi. Kemi bërë marrëveshje me ATK-në që pagesën t'a bëjmë me kështu. Sa i përket planit dinamik dhe referencave i kam me vete këto dokumente.

Kryesuesi i komisionit, z. Besnik Bajra, çështje tjetër për shqyrtim është edhe çështja e rrugës.

Z. Zekirja Elezi. Ju falenderoj dhe ju nderoj për afarizmin tuaj, të dy kompanive. Sa i përket pronave që do ju jepen në shfrytëzim, ne si komision duhet të bëjmë një analizë

për zhvillimin strategjik të komunës. Kemi kërkesë nga Ishatrat që janë afër pronave që të kenë një rrugë për dalje në "fushën e mules".

Asim Vogliqi, ju kemi aplikuar për parcelën 217-0, Z.K. Gërlicë e Epërme.

Muhamet Zenuni, ju kemi aplikuar për parcelën 217-0, Z.K. Gërlicë e Epërme dhe parcelat 121-0 dhe 124-0, Z.K. Doganaj. Sa i përket parcelës 121-0, Z.K. Doganaj, Kuvendi nuk ka marr vendim që të jepet në shfrytëzim.

Rruga e re do të jetë e gjërë 15 m. Një pjesë e rrugës së re kalon në parcelën 124-0, Z.K. Doganaj me sipërfaqe 327 m², ndërsa një pjesë kalon në parcelën 217-0, Z.K. Gërlicë e Epërme, me sipërfaqe 1356 m².

Kryesuesi i komisionit, z. Besnik Bajra, Sa i përket parcelës 121-0, ne si komision do t'i propozojmë Kuvendit që të marr vendim që edhe kjo parcelë të jepet në shfrytëzim.

Z. Muhamet Zenuni, Ju falenderoj për ftesën. Ne si kompani kemi kërkuar që këto parcela të na ipen në shfrytëzim për 99 vite. A duhet të paguhet ndonjë taksë komunës pasi që do të ipen vetëm për 40 vite.

Kryesuesi i komisionit, z. Besnik Bajra, Për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurt prej 1- 5 vite , duhet të paguhet taksë, ndërsa për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë , nuk paguhet taksë komunës.

Z. Muhamet Zenuni, Kur kanë dalë pronat në konkurs public, kam pritur të ketë konkurrencë. Ne kemi 3 vite që kemi bërë kërkesë për këto parcela. Unë kam paraparë heqjen e dheut në atë pjesë , në bashkëpunim me komunën. Unë kam blerë edhe prona tjera që janë afër me këto pacela të komunës me qëllim të një investimi prej 2 milion euro. Sa i përket rrugës, jam në dijeni se do të bëhet kjo ndarje e rrugës, mirëpo nëse ka mundësi të bëhet një ndryshim i rrugës.

Z. Asim Vogliqi, I kam parë parcelat e ndara. Unë nuk kam aplikuar për parcelat tjera, por vetëm për parcelën 217-0, Z.K. Gërlicë e Epërme. Kam një projekt biznesi, që ndoshta kushton pak por prioritet ka punësimin e 35 punëtorëve. Nuk mund të pajtohem që kjo parcelë t'i ipe dikujt tjetër.

Z. Kadri Krivenjeva, Jam falenderues për njerëzit që investojnë në biznese. Qëllimi juaj është i mirë, mirëpo duhet të dihet edhe interes i komunës, duhet të veprojmë në të mirë të qytetarëve të komunës.

Kryesuesi i komisionit, z. Besnik Bajra, Kjo zonë është e përcaktuar si zonë industriale, konkretisht për fabrika, biznese. Sipas ligjit kriteret janë oferta ekonomike më e favorshme dhe punësimi.

Projektet janë shumë të mira, si e kompaninë "X-PLAST" ashtu edhe e kompanisë "MUJA". Në fund ne si komision do të vendosim.

Nëse brenda 3 muajve të lidhjes së kontratës, nuk filloni me punimet, do t'ju merret e drejta e shfrytëzimit të pronës së komunës.

Sipas ligjit kompania "X-PLAST" i plotëson të gjitha kriteret për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Znj. Kaltrina Tafili, Nëse parcelën 121-0, Z.K. Doganaj, e propozojmë në Kuvend për dhënie në shfrytëzim, a i plotëson kushtet për biznesin tuaj, z. Zenuni.

Z.Zekrija Elezi. Është bërë një analizë prej rrugës së "fushës së mulës". Kjo rrugë do të jetë në fuksion të dy kompanive, gjëresia është 15 m. Kemi menduar që në të ardhmen të bëhet një rrethrotullim që do të lidh fshatrat Dura, Gabrricë, Elezaj dhe këtë rrugë. Rruga është traituar në të gjitha aspektet. Në bazë të dokumenteve të kërkuara në konkursin publik, kompania "X-PLAST" i ka plotësuar të gjitha kriteret, ndërsa investimi i kompanisë "MUJA" është shumë i madh dhe për këtë arsye ju japim mundësi të dy kompanive për marrjen e parcelave.

Z.Besnik Salihu. pyetje për Asim Vogliqin, parcela që ju është ndarë a është e mjaftueshme për biznesin tuaj?

Z.Asim Vogliqi. Ne mendojmë të zgjerohemi më shumë, sepse pronat që janë afër kësaj parcele janë tonat. Gjithashtu pajtohem me çështjen e rrugës. Unë jamë bazuar në këtë sipërfaqe që e ka në konkurs publik parcela 217-0. Unë nuk kam nevojë të rri më shumë në takim, jus i komision vendosni për parcelat, pastaj nëse ka nevoj për kompromis me kompaninë "MUJA" bisedojmë.

Z.Muhamet Zenuni. Edhe unë pajtohem me çështjen e rrugës.

Kryesuesi i komisionit, Z.Besnik Bajra. Qëllimi është që projekti të kryhet sa më shpejt, në mënyrë që të punësohen më shumë persona.

Z.Muhamet Zenuni. Edhe unë po ju lë të lire të kryeni punët jus i komision, ju përsëndes.

Z.Zekrija Elezi, ne si komision propozojmë që propozimi për ndarjen fizike të rrugës t'i jepet Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit, me qëllim të krijimit të rrugës së re.

Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, mori këtë Vendim:

N.P."X-PLAST" i jepet në shfrytëzim nga komuna, 6608 m² të parcelës kadastrale 217-0, Z.K.Gërlicë e Epërme, ndërsa

N.P.T."MUJA" i jepet në shfrytëzim nga komuna, parcela kadastrale 124-0 Z.K.Doganaj dhe 1356 m² të parcelës kadastrale 217-0, si dhe pjesën e rrugës e cila nuk është në funksion dhe do të zëvendësohet me rrugën e re. Një pjesë e rrugës së re kalon në parcelën 124-0 Z.K.Doganaj me sipërfaqe prej 327m², ndërsa një pjesë kalon në parcelën 217-0 Z.K. Gërlicë e Epërme me sipërfaqe 1356 m².

Vërejtje: Këto sipërfaqe do të marrin formën zyrtare vetëm pas aktivitetit teknik (ndarjes fizike) të rrugës, të cilat duhet t'i ndërmer Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit. Mund të ndodh që këto sipërfaqe të pësojnë devijime të vogla për shkak të normave teknike.

Gjithashtu në këtë takim, Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës propozon që: parcela kadastrale, 215-0 e cila evidentohet në Z.K.Gërlicë e Epërme, të hiqet nga Vendimi i Kuvendit 01Nr.16-4996/2016, për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë, që kjo parcelë të mos ipej në shfrytëzim për arsye se parcela është e destinuar për varreza.


Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës
proponon që parcela kadastrale 121-0, Z.K. Deganaj të propozohet në Kuvend për
dhënie në shfrytëzim afatgjatë.

Mbledhja përfundoi në ora 13:00.

Procesmbajtës
Arbnora Kuka



Kryesues i Komisionit
Besnik Bajra





REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E KACANIKUT • OPŠTINA KACANIK • MUNICIPALITY OF KACANIK



KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT

Duke u bazuar në nenet 2,3parag.1.4, nenet 6, 7, 8 të Ligjit Nr.04/L-144, për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 2 parag.4 nenet 11,12,13,14,15,16,17,18 në Rregulloren QRK Nr.23/2013 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, vendimi paraprak për dhënie e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë 01.Nr.16-4996/2019 të datës 15.02.2016 dhe vendimi për ndryshim plotësimin paraprak të Kuvendit Komunal të Kaçanik për dhënie e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë, 01Nr.104-2-9777/2017, Komisioni Vlerësues i ofertave për dhënie e pronës së paluajtshme në shfrytëzim i caktuar me vendim të Kuvendit të Komunës së Kaçanik, 01.Nr.104/02-2312/19, të dt. 29.01.2019, në mbledhjen e mbajtur me datë 13.03.2019 vendos për shpallje:

KONKURS PUBLIK Nr.01/2019

KONKURSI PUBLIK PËR DHËNIE E PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATGJATË

Konkursi publik për dhënie e pronave të paluajtshme në pronësi të Komunës,
përmban si në vijim:

- Parcela Kadastrale nr. P-70917086-01405-0, ne sipërfaqe te përgjithshme 6628 m² P.SH. KK Kaçanik, me kulturë kullosë e klasës 3, qe gjendet ne "Çardak"-Zona Kadastrale Kaçaniku i Vjetër- Kaçanik
- Parcela Kadastrale nr.P-70917086-00402-0, ne sipërfaqe te përgjithshme 9548 m², P.SH.KK Kaçanik, me kulture kullosë e klasës 4, qe gjendet ne vendin e quajtur: "Gllavica" Zona Kadastrale Kaçaniku i Vjetër-Kaçanik
- Parcela Kadastrale nr.P-70917086-00403-0, ne sipërfaqe te përgjithshme 3299 m², P.SH.KK Kaçanik, me kulture kullosë e klasës 3, qe gjendet ne vendin e quajtur: "Gllavica – Mahalla e Përzhive" Zona Kadastrale Kaçaniku i Vjetër-Kaçanik
- Parcela Kadastrale nr. P-70917003-01579-0, në sipërfaqe te përgjithshme 6840 m², P.SH .K.K .Kaçanik me kulture kullose e klasës 3, qe gjendet ne vendin e quajtur " Gllavica Fusha e Mole" Zona Kadastrale Begracë-Kaçanik.

- Parcela Kadastrale nr.P-70917003-02647-0, në sipërfaqe të përgjithshme **2764m²**, P.SH.K.K.Kaçanik me kultur kullose e klasës 3,që gjendet në vendin e quajtur **"Tren Mala Fusha Mole"**Zona Kadastrale **Begracë-Kaçanik**
- Parcela Kadastrale nr.P-70917003-01580-0, në sipërfaqe të përgjithshme **23379m²**, P.SH.K.K.K.Kaçanik me kultur kullose e klasës 3,që gjendet në vendin e quajtur **"Tren Mala Fusha Mole"**Zona Kadastrale **Begracë-Kaçanik**
- Parcela Kadastrale nr.P-70917021-00217-0, në sipërfaqe të përgjithshme **9413m²**, P.SH.K.K.K.Kaçanik, gjendet në vendin e quajtur **"Kërdhak-Toska"**Zona Kadastrale **Gërlicë e Epërme-Kaçanik.**
- Parcela Kadastrale nr.P-70917026-00124-0, në sipërfaqe të përgjithshme **4601m²**, P.SH.K.K.K.Kaçanik me kultur kullose e klasës 5 që gjendet në vendin e quajtur **"Kaliman Vore Te Tenes"**Zona Kadastrale **Doganaj -Kaçanik.**

Afati i dhënies në shfrytëzim

- Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës është afatgjatë prej katërdhjetë (40) vite.

Veprimtaria që ushtrohet sipas destinimit të pronës:

- Parcelat të theksuara më lartë janë të destinuara për **biznes** – zona industriale me (PZH) Vendim të Kuvendit të Komunës.

Kriteret për vlerësimin e ofertave

- Oferta ekonomike më e favorshme
- Vlera e investimit;
- Numri i të punësuarve nga investimi;
- Lloji i investimit që është me interes publik për komunën

Kohëzgjatja e shpalljes së konkurimit publik dhe data e fundit e dorëzimit të ofertave:

- Kohëzgjatja e shpalljes së konkurimit publik për dhënien e pronave për shfrytëzim afatgjatë është **dyzet e pesë (45) ditë** nga dita e publikimit në ueb-faqen e Komunës, në vendet publike, elektronike dhe të shkruara.
- Dokumentacioni për ofertim tërhiqet në Qendrën për shërbim ndaj qytetarëve (kati përdhësë nr. 5) nga **data 21.03. 2019, deri me datë: 04.05.2019** në ora: **16:00 h.**
- Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në Qendrën për shërbim ndaj qytetarëve, çdo ditë pune prej orës **08:00 deri 16:00.**

Vendi, koha ku do të mbahet i konkursit publik:

- Në sallën e Kuvendit Komunal, me dt. **06.05.2019**, në fillim në ora: **10:00**, do të bëhet hapja e ofertave dhe të njëjtat do të bëhen publike gjatë hapjes, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në konkurs publik.

Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në konkurs publik;

- Të drejtë pjesëmarrje dhe konkurimi, kanë të gjithë personat fizik dhe juridik të republikës së Kosovës dhe investitorët e huaj;
- Marrëveshja e bërë do të bëhet konform planit ideor, planit të biznesit dhe planit dinamik të investimeve të dorëzuara dhe të njëjtat do të ë jetë obliguese për të zbatuar;

- Kontrata për dhënjën në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, nënshkruhet nga kryetari i komunës dhe nga fituesi i zgjedhur, brenda 15 ditësh pune nga data e miratimit të ofertës nga ana e Kuvendit të Komunës.
- Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë komisionit për vlerësimin e ankesave në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh.
- Nëse komisioni i ankesave konstaton se ka shkelje gjatë procesit të vlerësimit ka të drejtë të kërkojë rishqyrtimin e procesit, por nëse komisioni i ankesave vlerëson se nuk ka bazë, atëherë ankesën e refuzon si të pabazuar.
- Fituesi duhet të nënshkruaj regjistrin e procedurës së konkursit publik. -Nëse informatat e dhëna nga ofertuesi dëshmojnë si të pasakta, komisioni ka të drejtën që të refuzojë dhënien e pronës në shfrytëzim.

Pjesëmarrësve në konkurrim iu garantohet e drejta që të:

- Informohen lidhur me procedurat e konkursit publik,
- Shohin pronën që do të jepet në shfrytëzim,
- Kanë qasje në dokumentacionet e pronës,
- Tërhiqen nga ankandi jo më vonë se tre (3) ditë para mbajtjes së konkursit publik.
- **Të interesuarit mund të informohen (çdo ditë pune) përmes:**
- Ueb faqës -<http://kk-rks-gov.net/kacanik/>
- Te.038-200 46-423, Email Besnik.Bajra @rks-gov.net

Kaçanik ; 20.03.2019

Kryesuesi i Komisioni vlerësues i Ofertave

